



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
GJENDJES CIVILE

NR. 1243 PROT., DATË 20.07.2022

NR. 7683 PROT., DATË 20.7.2022

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet:

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

në vijim i referuar si “INSTAT”

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE

në vijim i referuar si “DPGJC”

Duke pasur parasysh se:

INSTAT është institucioni përgjegjës për të siguruar që statistikave zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen sipas parimeve të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” (në vijim referuar “Ligji i statistikave”);

Neni 13, pika 2 (ë) e ligjit të statistikave parashikon që INSTAT mund të hartojë, negociojë e të nënshkruajë memorandume mirëkuptimi me të gjitha agjencitë statistikore dhe me mbajtësit e të dhënave administrative, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet e palëve;

Neni 13, pika 1 (ç) e ligjit të statistikave parashikon që INSTAT duhet të marrë pjesë në proceset e krijimit dhe zhvillimit të sistemeve të të dhënave administrative, për tu përdorur për qëllime statistikore;

Neni 25, pika 8 e ligjit të statistikave parashikon detyrimin që kanë të gjitha institucionet publike që të njoftojnë INSTAT-in për çdo projektakt të propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave apo në Kuvendin e Shqipërisë i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në veprimtarinë statistikore që ushtrohet në Republikën e Shqipërisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 33, pika 1 e ligjit të statistikave parashikon që të gjitha institucionet qendrore dhe vendore i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat, skedarët e të dhënave dhe të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura, sipas përgjegjësive përkatëse, në masën që është e nevojshme për nxjerrjen e statistikave, duke shmangur ngarkesat në përgjigje për njësitë statistikore;

Neni 33, pika 2 e ligjit të statistikave detyron institucionet publike të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese;

Neni 31 i ligjit të statistikave detyron INSTAT-in të trajtojë si konfidenciale çdo të dhënë të mbledhur, përpunuar dhe ruajtur për nxjerrjen e statistikave zyrtare;

Neni 40, pika 1 e ligjit të statistikave parashikon që ky ligj prevalon ndaj çdo dispozite të parashikuar në ligje të tjera, në bazë të të cilave ushtrojnë veprimtarinë institucionet publike, gjë që bëhet pengesë për dhënien dhe transmetimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore ose për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura vetëm për qëllime statistikore;

Ligji nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, neni 8, pika 3, ngarkon INSTAT të ngrejë Regjistrin Statistikor të Popullsisë dhe Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave;

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile funksionon në bazë të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar;

Si dhe duke pasur parasysh se Sistemi Kombëtar Statistikor bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT-it nga njëra anë dhe agjencive të tjera statistikore dhe mbajtësve të të dhënave administrative nga ana tjetër;

Instituti i Statistikave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bien dakord të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:

Neni 1

Qëllimi Memorandumit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi (në vijim i referuar si “Memorandumi”) synon rregullimin e marrëdhënieve midis dy institucioneve: INSTAT, si prodhuesi kryesor zyrtar i statistikave në Shqipëri dhe DPGJC, si institucioni mbajtës i Regjistrit Themeltar të Shtetasve dhe Adresarit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

duke përcaktuar përgjegjësitë për hartimin, shpërndarjen, transmetimin, shkëmbimin e të dhënave si dhe fushat dhe kushtet e bashkëpunimit për prodhimin e statistikave zyrtare nën Programin e Statistikave Zyrtare si edhe në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022.

2. Memorandumi i Mirëkuptimit synon të rrisë performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, duke rregulluar mënyrën e organizimit të punës, transmetimit të të dhënave si dhe detyrimet e ndërsjella të institucioneve nënshkruese në kuadër të këtij bashkëpunimi.
3. INSTAT synon të sigurojë aksesin e plotë në variablat ekzistues të Regjistrit Themeltar i Shtetasve Shqiptarë dhe të vlerësojë mundësinë për shtimin e variablave të tjerë në funksion të shtimit të statistikave zyrtare nëpërmjet ndërtimit të Regjistrit Statistikor të Popullsisë.
4. INSTAT synon të sigurojë aksesin e plotë në variablat ekzistues të adresarit dhe vlerësimin e mundësisë për shtimin e variablave të tjerë në funksion të shtimit të statistikave zyrtare nëpërmjet ndërtimit të Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave.
5. Në kuadër të këtij memorandumi ndërmjet palëve, INSTAT dhe DPGJC, do të bashkëpunojnë në fushën statistikore me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e prodhimit statistikor në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, për tu përgjigjur në kohë dhe në mënyrën e përshtatshme, kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për informacion statistikor.

Neni 2

Pavarësia Profesionale

1. Në mbështetje të nenit 4 të Ligjit të statistikave, INSTAT dhe agjencitë statistikore si dhe institucionet që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna administrative dhe statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Për këtë qëllim, DPGJC-ja merr përsipër të zbatojë parimet e besueshmërisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të të dhënave statistikore. DPGJC ndërmerr veprime kundër çdo përpjekje për influencim nga autoritete të tjera, vendase apo të huaja, dhe informon INSTAT-in.
2. DPGJC garanton disponibilitetin e burimeve njerëzore të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum Mirëkuptimi si dhe ndërmerr veprimtari të tjera që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor brenda institucionit.

Neni 3

Modalitetet e bashkëveprimit

Me qëllim që të sigurohet zbatimi i këtij Memorandumi, brenda një muaji nga data e nënshkrimit të tij krijohet një grup pune përgjegjës për të koordinuar aktivitetet e palëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

1. Grupi i Punës:

- a) Përbëhet nga të paktën 2 anëtarë të zgjedhur me konsensusin e titullarëve të institucioneve, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë mes palëve;
- b) Kryesohet nga një përfaqësues i INSTAT-it, anëtar i Grupit të Punës;
- c) Mblidhet të paktën çdo gjashtë muaj ose kur kërkohet nga njëra palë;
- d) Mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhje ekspertë teknikë ose funksionarë të tjerë që kanë lidhje apo mund të japin mendim për çështje të ndryshme brenda objektit të punës.

2. Grupi i punës ka këto detyra:

- a) Monitoron zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara duke verifikuar në çdo fazë përputhjen mes objektivave dhe rezultateve të arritura;
- b) Tërheq vëmendjen për vonesat në shkëmbimin e informacionit apo keqfunksionimin e zbatimit të detyrave;
- c) Përcakton shkaqet dhe pengesat që ndalojnë arritjen e plotë të rezultateve të pritshme;
- d) Paraqet propozime për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë edhe modifikimet e mundshme të Memorandumit dhe anekseve pjesë integrale të tij, si dhe ia paraqet për miratim institucioneve, sipas të njëjtës procedurë që ndiqet për nënshkrimin e këtij memorandumi;
- e) Propozon formën e transmetimit të të dhënave duke përdorur metoda elektronike të sigurta (Paketa Integrimi) si dhe specifikimet teknike për këtë mënyrë;
- f) Propozon iniciativa specifike për rritjen profesionale të statistikienëve nëpërmjet kurseve të trajnimit, pjesëmarrjes në takime pune me organizatat partnere brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrjes në konferenca, seminare dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me prodhimin statistikor;
- g) Propozon fillimin e projekteve kërkimore dhe studimore në sektorë të veçantë të interesit të përbashkët;
- h) Ndërmerr iniciativa për të mbështetur zbatimin korrekt të të drejtës së hyrjes dhe shkëmbimit të të dhënave.

Neni 4

Udhëzimet për standardet profesionale

- 1. INSTAT detyrohet të vendosë në statistikat zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty ku është e mundur (Neni 14, pika 2 (e) e ligjit të statistikave).
- 2. Udhëzimet për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Aneksin bashkëngjitur këtij memorandumi propozohen nga Grupi i punës sipas nenit 3 të Memorandumit dhe miratohen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

me mirëkuptimin e palëve.

3. Udhëzime mbi standardet profesionale dhe të dhënat që do të shkëmbehen, duhet të përditësohen në përputhje me teknikat inovative elektronike si dhe praktikën e krijuar gjatë zbatimit të Programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare.
4. DPGJC siguron që puna për prodhimin e statistikave nën autoritetin e saj do të kryhet në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga INSTAT.
5. INSTAT ofron trajnime apo seminare pune për rritjen e aftësive profesionale të stafit të DPGJC në kuadër të prodhimit, administrimit dhe raportimit të dhënave profesionale.

Neni 5

E drejta e hyrjes dhe shkëmbimi i të dhënave

1. Për prodhimin e statistikave zyrtare sipas Programit të Statistikave Zyrtare, DPGJC bën zhvillimet e duhura në prodhimin e informacionit për qëllime statistikore rënë dakord midis palëve sipas anekseve pjesë përbërëse e këtij Memorandumi. Këto informacione do të dërgohen zyrtarisht në formë shkresore, në format elektronik ose kombinim i këtyre dy formave sipas afateve të rëna dakord midis palëve në aneksin bashkëlidhur këtij Memorandumi.
2. Të dhënat që transmetohen, forma, frekuenca, niveli i detajimit dhe periudha e transmetimit përcaktohen në mënyrë të detajuar në Aneksin (ku është aneksi) pjesë përbërëse e këtij Memorandumi.
3. Transmetimi i të dhënave kryhet pa pagesë.
4. INSTAT garanton mbështetjen teknike dhe metodologjike për zbatimin e duhur të Memorandumit.
5. INSTAT furnizon DPGJC pa pagesë me publikimet statistikore që prodhën institucioni.
6. Të dhënat e transmetuara nga DPGJC tek INSTAT, trajtohen si të dhëna konfidenciale dhe administrohen duke respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat e parashikuara në Nenin 31 “Konfidencialiteti” i ligjit të statistikave dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 6

Sigurimi i zbatimit të përshtatshëm të programit

1. INSTAT është institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor.
2. INSTAT është përgjegjës për zbatimin e përshtatshëm të Programit pesë vjeçar të statistikave zyrtare dhe raportimin e ecurisë së tij para Kuvendit.
3. INSTAT është i detyruar të organizojë dhe kryesojë takime të zgjeruara këshillimore me drejtuesit e strukturave që ndjekin çështjet statistikore, për çështje të interesave profesionale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dhe për realizimin e programit, problemet dhe veprimet e nevojshme për përmirësimin e tij.

4. Për të realizuar kërkesat e përmendura në pikat 1, 2, dhe 3 të këtij Neni, palët nënshkruese të Memorandumit e rregullojnë bashkëpunimin e tyre si më poshtë:
 - a) DPGJC njofton INSTAT për çdo vrojtim statistikor i cili parashikohet të kryhet nga ky institucion apo nga çdo institucion tjetër nën përgjegjësinë e saj. INSTAT jep opinionin e tij për projektin brenda gjashtë javëve. Nëse nuk jepet një përgjigje brenda këtij afati, projekti konsiderohet i miratuar.
 - b) Procedurat për prodhimin e statistikave të zbatuara nga DPGJC shqyrtohen nga INSTAT. Për të plotësuar këtë detyrim, INSTAT-it i jepet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm statistikor. INSTAT merr përsipër të specifikojë informacionin që kërkon brenda një afati të arsyeshëm, ndërsa DPGJC i transmeton dokumentet në kohën dhe formën e kërkuar nga INSTAT duke respektuar legjislacionin në fuqi.
 - c) Me kërkesë të INSTAT-it, DPGJC jep informacion mbi përparimin e bërë lidhur me detyrat e vendosura në Programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare.
 - ç) DPGJC njofton dhe merr mendim paraprakisht nga INSTAT-i për çdo akt ligjor ose nënligjor i cili i propozohet për miratim Kuvendit ose Këshillit të Ministrave dhe që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në aktivitetet statistikore që kryhen në Republikën e Shqipërisë.
5. Me qëllim që të rrisë përdorimin statistikor të të dhënave administrative, DPGJC bie dakord me INSTAT-in që, nëpërmjet Grupit të Punës të ngritur sipas nenit 3 të këtij Memorandumi, të modifikojë, integrojë dhe hartojë formularët që përmbajnë informacion statistikor, duke siguruar që përkufizimet dhe klasifikimet përkatëse të jenë në përputhje me ato të përdorura nga INSTAT dhe i gjithë Sistemi Kombëtar Statistikor.

Neni 7

Marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare për çështjet statistikore

1. INSTAT detyrohet të përditësojë informacionin për marrëdhëniet midis agjencive statistikore dhe agjencive ndërkombëtare për çështjet që lidhen me statistikat zyrtare shqiptare.
2. DPGJC mban të informuar INSTAT-in për të gjitha takimet e parashikuara për çështje statistikore. Informacioni duhet të jepet paraprakisht dhe do të tregojë nëse INSTAT-it i kërkohet të marrë rolin e përfaqësuesit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe nëse takimi implikon edhe agjenci të tjera statistikore shqiptare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë nga Memorandumi apo në lidhje me të do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave mes INSTAT-it dhe DPGJC-së, ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht.

Neni 9

Ndryshimi dhe përfundimi

1. Ky Memorandum lidhet për një kohë të pacaktuar dhe është subjekt i ndryshimeve vetëm me konsensusin e të dyja palëve.
2. Secila palë mund ta përfundojë Memorandumin duke lajmëruar me shkrim palën tjetër 30 ditë para përfundimit.
3. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit sipas përcaktimeve të nenit 8. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij nga përfaqësuesit e palëve.

Nënshkruar në Tiranë, më _____ 2022 në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku secila ka vlerë të njëjtë ligjore.

**PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
GJENDJES CIVILE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VANGJUSH STAVRO



**PËR
INSTITUTIN E STATIKSTIKAVE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHULLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ANEKS

Të dhënat që do të sigurojë **Drejtoria e Përgjithshme Gjendjes Civile**, në zbatim të PSZ-së si dhe kërkesave prej institucioneve ndërkombëtare:

1. Të dhëna për numrin e individëve në Regjistrin e Gjendjes Civile, frekuencë vjetore

- a) Shtetasit shqiptarë sipas bashkisë, gjinisë dhe datëlindjes;
- b) Shtetasit shqiptarë (jashtë shtetit) sipas bashkisë, gjinisë dhe datëlindjes;
- c) Statusi i gjendjes civile sipas bashkisë, gjinisë dhe datëlindjes;
- d) Numri i familjeve sipas bashkisë;

2. Lëvizjet e brendshme të popullsisë, frekuencë vjetore

- a) Të ardhur sipas bashkive, gjinisë dhe moshës;
- b) Të larguar sipas bashkisë, gjinisë dhe moshës;

3. Lindjet, frekuencë 3-mujore

- a) Skedat e lindjeve;
- b) Numri i lindjeve të kryera jashtë vendit sipas muajve;

4. Vdekjet, frekuencë 3-mujore

- a) Skedat e vdekjeve;
- b) Numri i vdekjeve të kryera jashtë vendit sipas muajve;

5. Martesat, frekuencë 3-mujore

- a) Skedat e martesave;

6. Sistemi i adresave

Për sa i takon informacionit të gjeoreferuar, nevojiten të dhëna vektoriale me frekuencë 6-mujore te adresarit, si vijon:

- a) Gjurma e ndërtesës;
- b) Numërtimi i ndërtesave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- c) Hyrjet në këto ndërtesa;
- d) Apartamentet respektivë që ndodhen në hyrjet përkatëse;
- e) Emri dhe kodi i bashkisë ku ndodhet ndërtesa;
- f) Emri dhe kodi i njësisë administrative, në të cilën ndodhet ndërtesa;
- g) Emri dhe kodi i qytetit ose fshatit ku ndodhet ndërtesa;
- h) Kufiri dhe Kodi Postar ku ndodhet ndërtesa;
- i) Segmenti rrugor bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa, kategoritë dhe kodet përkatëse;